



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:071975

Datë: 02.07.2020

Numri i dokumentit: 01002780

P.nr.100/2020

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm**, me Gjyqtarin Fatos Sejdiqaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit Xh.M nga fsh.K. i P.,Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.810/2020, të datës 17.06.2020 (2020:0032953), duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 02.07.2020, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.810/2020 e datës 17.06.2020 dhe gjykata e jepë këtë :

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **I akuzuari Xh. M**, nga babai T dhe nëna V, i vajzërisë M i lindur me datë në K i P.,Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal,

Ë S H T Ë F A J T O R

- **SEPSE** : Nga dita e pa vërtetuar e deri më 28.03.2020 në fsh.K i P.,Komuna Skenderaj, i pandehuri me ane të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompenzimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla ashtu që, i pandehuri ka bërë ndërhyrje ilegale të paautorizuar pasi që ka hjekur furnizimin nga njehsori dhe e ka kyqur direkt në siguresën e daljes së njehsorit duke anashkaluar njehsorin dhe duke e furnizuar tërë objektin jashtë njehsorit, me çka i ka shkaktuar dëm kompanisë KEDS në vlerë prej 379.21 Euro.

- **Me këtë ka kryer veprën penale - Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të akuzuarares i shqipton :

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 30 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20.00) Euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a-KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.810/2020 të datës 17.06.2020, kundër të akuzuarit Xh. M nga fsh.K i P.,Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Vjedhja e Shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se e akuzuara ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhërit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjykata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se e akuzuara ka kryer veprën penale në fjalë si : Kallëzimi penal i Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike-KEDS Nr.CMS-K/DMI-182/2020 i datës 05.06.2020, Procesverbali i KEDS-it Nr.0925133 i datës 28.03.2020, Fatura e KEDS-it DMIHP2015925 e datës 02.04.2020, Kalkulimi RH Nr.11868 i datës 02.04.2020, foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale **Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së**, në kohën, në vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës, gjykata mori parasysh dhe vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të njëjtin rrethanë lehtësuese gjeti, rrethanat e tij personale, ndërsa rrethanë rënduese në rastin konkret gjeti faktin se veprat penale të kësaj natyre janë në rritje e sipër, andaj duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cekura si më lartë gjykata të akuzuarës i shqiptoj dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejtë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

- Departamenti i Përgjithshëm -

P.nr.100/2020 me datë 02.07.2020.

**Procesmbajtësja,
Florije Gucati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdiqaj**

- **KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.